



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Iu f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **26 nëntor 2020 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 29 tetor 2020;
2. Shqyrtimi i Draft – statutit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të teatrit të qytetit të Vushtrrisë (**shqyrtimi i dytë**);
3. Shqyrtimi i Draft – rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës (**shqyrtimi i parë**);
4. Shqyrtimi i propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh;
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;
6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 357/19, dt. 26.12.2019;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit 01 nr. 57/18, dt. 22.02.2018;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimeve për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq – dega në Vushtri;
10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A Vushtri;
11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal;
12. Shqyrtimi i Draft - Strategjisë Zhvillimore të Komunës për vitet 2020 – 2025 (**shqyrtimi parë**);
13. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë të përkrahjes së prodhuesve në Komunën e Vushtrrisë (**shqyrtimi parë**); ;

14. Shqyrtimi i Propozim vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
15. Shqyrtimi i konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial.
16. Të ndryshme.

Bashkëngjitur me ftesë iu dërgojmë rekomandimet e KPF-së dhe materialet për pikat e rendit të ditës.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit